



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së shtetit. Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në seancën e 63-të të mbajtur më 15.03.2022 ka miratuar

Vendim

Procedura për lëndën me nr. 08-3892 / 1 datë 09.10.2021, NDËRPRITET.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-3892/1 datë 09.10.2021.

Lënda me numër 08 –3892/1 të datës 09.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-3892 / 1 të datës 09.10.2021 është formuar me vetiniciativë .

Nga mbikëqyrja e evidencave të saj, KSHPK konstatoi se personi -----nuk ka dorëzuar fletë anketuese në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në afatin e paraparë me ligj prej 30 ditësh pas zgjedhjes për anëtar të Bordit të -----.

KSHPK-ja përpiloi raport për kundërvajtjen dhe urdhërpagesën e konstatuar ia dorëzoi personit _____. Më datë 20.01.2022 ka paguar gjobën në shumën e shënuar në urdhërpagesë për kundërvajtje.

KSHPK, pas shqyrtimit të lëndës, konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtejshëm kompetent në rastin konkret.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. Antonija A. Tasevska

Miratoi: Goran Trpenoski, anëtar

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР
ПЁР PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

